



UNIVERSITETI I PRISHTINES
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bishri Ndertesi e Rektoratit, 0000 Prishtinë, R. e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorat@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.:

837

Date: 02/07-2021

RAPORTI I VLERËSIMIT PËR DORËSHKRIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS SË
MASTER-i

Fakulteti	i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Komunikacionit/Trafik dhe transport
Projektpropozimi	<i>Analiza dhe simulimi i rrugëve në hyrje të qytetit të Podujevë</i>
Kandidati	Bsc. Gani Latifi
Mentori	Prof. Dr. Beqir Hamidi
Aprovimi i Projektpropozimit në Këshillin e fakultetit	Datë: Vendimi me nr.:

Vlerësimi i dorëshkrimit:

Në bazë të vendimit të Dekanit të Fakultetit, 679/2-13 të datës 28.05.2021 është formuar komisioni me këtë përbërje:

1. Prof. Asoc. Dr. Shpetim Lajqi, kryetar,
2. Prof. Dr. Beqir Hamidi, mentor,
3. Prof. Ass. Dr. Ramadan Mazrekaj, anëtar.

për vlerësimin e punimit Master me titull: "*Analiza dhe simulimi i rrugëve në hyrje të qytetit të Podujevës*" ("*Analysis and simulation of roads at the entrance in the city of Podujeva*"), të kandidatit Bsc. Gani Latifi.

Pas kontrollimit të punimit të lartpërmendur Komisioni jep këtë:

RAPORT

Punimi me titull "*Analiza dhe simulimi i rrugëve në hyrje të qytetit të Podujevës*" ("*Analysis and simulation of roads at the entrance in the city of Podujeva*"), është hartuar në 7 kapituj dhe është ilustruar përmes figurave dhe tabelave.

Në kapitullin e parë është bërë identifikimi dhe përshkrimi i problemit i cili do të trajtohet në punim, dhe janë vendosur qëllimet e hulumtimit.

Në kapitullin e **dytë** janë dhënë njohuri të përgjithshme mbi Teknikën e Trafikut, aktivitetet e teknikës së Trafikut etj.

Në kapitullin e **tretë** janë dhënë njohuri të përgjithëshme për udhëkryqet klasike, udhëkryqet me rrethrotullim dhe udhëkryqet me sinjalizim ndriçues, ndarja e tyre, elementet funksionale, përparësit dhe të metat e tyre.

Në kapitullin e **katër** janë paraqitur të dhënat në mënyrë tabelare dhe grafike e automjeteve dhe këmbësorëve për udhëkryqet e shqyrtuara në qytetin e Podujevës, ku pas llogaritjeve matematikore dhe softuerike është bërë identifikimi i problemeve në këto udhëkryqe.

Në kapitullin e **pestë** janë dhënë propozimet për udhëkryqet e shqyrtuara si dhe është bërë vlerësimi me anë të softuerëve SimTraffic dhe PTV VISSIM. Krahasimi i rezultateve të fituara janë dhënë në formë tabelare.

Në kapitullin e **gjashtë** janë prezentua rekomandimet që kemi dhënë për udhëkryqet e shqyrtuara në qytetin e Podujevës në mënyrë tabelare dhe në mënyrë të projektuar, si dhe është bërë krahasimi i rezultateve të fituara për udhëkryqet e shqyrtuara.

Në kapitullin e **shtatë** janë dhënë përfundimi dhe rekomandimet për udhëkryqet e shqyrtuara në komunën e Podujevës.




PËRFUNDIM

Në bazë të shqyrtimit të punimit Master, Komisioni për vlerësim konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur, i shtjelluar përmes figurave, tabelave dhe vizatimeve.

Prandaj, Komisioni për vlerësimin e punimit Master, të kandidatit Bsc. Gani Latifi, me titull "*Analiza dhe simulimi i rrugëve në hyrje të qytetit të Podujevës*" ("*Analysis and simulation of roads at the entrance in the city of Podujeva*"), mendon se i plotëson të gjitha kriteret për punim Master, prandaj i propozon që të jepet në diskutim publik.

Prishtinë, 25.06.2021

Komisioni:

1. 
(Prof. Dr. Beqir Hamidi, mentor)
2. 
(Prof. Asoc. Dr. Shqipërim Lajqi, kryetar)
3. 
(Prof. Ass. Dr. Ramadan Mazrekaj, anëtar)

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I INZHINIERISË MEKANIKE

PROGRAMI STUDIMOR: KOMUNIKACION RRUGOR



PUNIM DIPLOME

Kandidati:

Bsc. Gani Latifi

Mentori:

Prof. Dr. Beqir Hamidi

Prishtinë, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

PROGRAMI STUDIMOR: KOMUNIKACION RRUGOR



PUNIM DIPLOME

**Tema: “ANALIZA DHE SIMULIMI I RRUGËVE NË HYRJE TË
QYTETIT TË PODUJEVËS”**

***" ANALYSIS AND SIMULATION OF ROADS AT THE ENTRANCE IN
THE CITY OF PODUJEVA "***

Kandidati:
Bsc. Gani Latifi

Mentori:
Prof. Dr. Beqir Hamidi

Prishtinë, 2021

ABSTRAKTI	6
1. HYRJE.....	7
1.1. Pozita gjeografike	8
1.2. Demografia.....	9
1.3. Qëllimi i punimit	9
1.4. Identifikimi dhe përshkrimi i problemit	11
2. KUPTIMI I TEKNIKËS SË TRAFIKUT RRUGOR	14
2.1. Aktivitetet përbërëse të teknikës së trafikut	15
2.2. Inxhinierët e trafikut	16
2.3. Karakteristikat e trafikut	16
2.4. Jolineariteti kohor i qarkullimit të automjeteve	17
2.5. Jolineariteti në orë i qarkullimit të automjeteve në periudhën njëditore	18
2.6. Jolineariteti ditor i qarkullimit në periudhë prej shtatë ditësh	18
2.7. Numërimet përkatëse të qarkullimeve	19
2.8. Niveli i shërbimit	20
3. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR UDHËKRYQET	22
3.1. Kapaciteti dhe niveli i shërbimit për udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues.....	22
3.2. Analiza e kapacitetit në udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues	23
3.3. Hapat metodologjik themelor gjatë analizës së kapacitetit dhe nivelit të shërbimit në udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues.....	23
3.4. Të dhënat e nevojshme hyrëse	23
3.5. Qarkullimi konfliktuoz	24
3.6. Kapaciteti potencial i lëvizjes	26
3.7. Kapaciteti i shiritit të përbashkët.....	27
3.8. Kriteri i nivelit të shërbimit.....	28
3.9. Njohuri të përgjithshme për rrethrotullimet.....	29
3.10. Siguria në rrethrotullim, pikat konfliktuoz	29
3.11. Elementet gjeometrike të rrethrotullimeve	30
3.12. Kategoritë e qarkullimeve rrethor	30
3.13. Mini-rrethrotullimet.....	30
3.14. Rrethrotullimet kompakte urbane	31
3.15. Elementet themelore të projektimit të rrethrotullimit.....	31
3.16. Shpejtësia	31
3.17. Distanca e pamjes	32
3.18. Rekomandimet e përmasave të diametrit të brendshëm dhe shpejtësive në hyrje të rrethrotullimit.....	32
3.19. Përparësitë dhe të metat e përdorimit të udhëkryqeve me rrethrotullim	33

3.20. Sinjalizimi në rrethrotullim.....	34
3.21. Koncepti i udhëkryqeve me sinjalizim	35
3.22. Sinjalizimi në udhëkryq	36
3.23. Diagramet fazore	36
3.24. Llojet e rregullimit të lëvizjes në të majtë dhe në të djathtë të automjeteve	36
3.25. Fazat e kalimtarëve	37
3.26. Niveli i shërbimit për udhëkryq të sinjalizuar	38
4. ANALIZA E TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NË RRJETIN RRUGOR TË SHQYRTUAR DHE IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE	39
4.1. Të dhënat për qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve për udhëkryqin që lidhë rrugët “Skënderbeu” dhe “Zahir Pajaziti”	39
4.2. Lloaritja e kapacitetit dhe nivelit të shërbimit për udhëkryqin e rrugëve “Skenderbeu” dhe “Zahir Pajaziti”	44
4.3. Vlerësimi i udhëkryqit me softuerin SimTraffic	47
4.4. Të dhënat për qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve për udhëkryqin që lidhë rrugët “Brigadat” dhe “Ramë Obranqa”	49
4.5. Lloaritja e kapacitetit dhe nivelit të shërbimit për udhëkryqin e rrugëve “Brigadat” dhe “Ramë Obranqa”	53
4.6. Vlerësimi i udhëkryqit me softuerin SimTraffic	57
4.7. Udhëkryqi rrethor i rrugëve “Skënderbeu”, “Brigadat” dhe “Rruga e Xhamisë”	59
Veçorit e rrethrotullimit ekzistues janë:	59
4.8. Llogaritja e kapacitetit dhe nivelit të shërbimit për rrethrotullimin ekzistues në hyrje të qytetit të Podujevës.....	64
4.8.1. Llogaritja e kapacitetit për hyrjet përkatëse	65
4.8.2. Llogaritja e shkallës së ngopjes:.....	65
4.8.3. Humbjet mesatare kohore	66
4.8.4. Llogaritja e numrit të automjeteve në radhë	67
4.9. Vlerësimi i rrethrotullimit me anë të softuerit SimTraffic	68
5. PROJEKTIMI DHE PROPOZIM I ZGJIDHJEVE TE MUNDSHME PËR SEGMENTIN RRUGOR TË PODUJEVËS.....	71
5.1. Propozimi për udhëkryqin e formes T i cili lidhë rrugët “Skënderbeu” dhe “Zahir Pajaziti”	71
5.1.1. Diagrami Fazor.....	72
5.1.2. Vlerësimi i udhëkryqit të propozuar me anë të softuerit SimTraffic.....	77
5.1.3. Vlerësimi i udhëkryqit të propozuar me anë të softuerit PTV VISSIM	79
5.2. Propozimi për udhëkryqin e Rrugëve “Brigadat” dhe “Ramë Obranqa”	81
5.3. PROPOZIMI PËR UDHËKRYQIN ME RRETHRROTULLIM I RRUGËVE “SKENDERBEU”, “BRIGADAT” DHE “RR. E XHAMISË”	82
5.3.1. Vlersimi i udhëkryqit me softuerin SimTraffic	83

5.3.2. Vlersimi i udhëkryqit të propozuar me anë të softuerit PTV VISSIM.....	84
6. DISKUTIMI i REZULTATEVE DHE KONKLuzionET.....	86
6.1 Paraqitja e udhëkryqit të rrugëve ‘Skënderbeu’ dhe ‘Zahir Pajaziti’	87
6.2. Paraqitja e udhëkryqit që lidhë rrugët “Brigadat”, dhe "Ramë Obranqa"	89
6.3. Paraqitja e udhëkryqit me rrethrotullim për Rrugët “Skënderbeu”, “Brigadat” dhe “Rr. e Xhamisë”	90
6.4. Krahasimi i gjendjes ekzistuese të udhëkryqeve dhe dy propozimeve të bëra	91
7. PËRFUNDIMI	92
8. LITERATURA.....	94

ABSTRAKTI

Në këtë punim, është bërë shqyrtimi i rrugëve në hyrje të qytetit të Podujevës, konkretisht në rrjetin e rrugëve: Rruga "Skënderbeu", Rruga "Zahir Pajaziti", "Rruga Brigadat", Rruga "Ramë Obranqa" dhe "Rruga e Xhamisë". Ky studim përfshinë mbledhjen e të dhënave në vend të ngjarjes me anë të matjeve, numërimit të pjesëmarrësve kryesor në rrjetin rrugor dhe pastaj përpunimin e këtyre të dhënave me anë të softuerit përkatës ku përfshihet modelimi dhe simulimi kompjuterik, analiza e rrjetit rrugor të marrë në shqyrtim me dhënien e rezultateve të parametrave kryesor të trafikut rrugor. Në pjesën e dytë do të bëhet propozimi i zgjidhjeve më optimale në ato pjesë të rrjetit ku janë vërejtur probleme që kërkojnë zgjidhje.

Studimi bëhet për orët e pikut (kulmore) të qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve. Qëllimi i temës është që në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse të bëhet analiza e këtij rrjeti rrugor bazuar në të dhënat e mbledhura nga gjendja ekzistuese në teren për secilën nyje, futja e të dhënave në softuer, krijimin e modelit kompjuterik - grafik në bazë të të dhënave, aplikimi i simulimit, dhe të jepen propozimet e zgjedhjeve më të mira

Rrjeti rrugor i shqyrtuar në hulumtimin tonë përbëhet prej këtyre llojeve të udhëkryqeve:

- *Një rrethrotullim dhe*
- *Dy udhëkryqe klasike të formës "T".*

Për shqyrtim të këtij segmenti rrugor është bërë modelimi dhe simulimi i rrjetit rrugor me anë të softuerit *SimTraffic*. Përfitimi i rezultateve gjithashtu do të bëhet me anë të softuerit *SimTrafik* që është softuer i sofistikuar për shqyrtimin e rrjetit rrugor si urban ashtu edhe ndër urban.

1. HYRJE

Me komunikacion në rrugë nënkuptohet lëvizja e mjeteve, këmbësorëve, si dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacion në rrugë publike dhe të pa kategorizuar të cilat shfrytëzohen për komunikacion publik.

Qytetaret në qytetin e Podujevës ballafaqohen me probleme të shumta siç janë: numri i madh i automjeteve, rrjeti rrugor nuk përballon kërkesat, numri i madh i kalimtarëve, paraqitja e fyteve të ngushta, pa mundësi për zgjerimin e rrjetit rrugor ekzistues e shumë probleme tjera.

Të dhënat e trafikut janë të nevojshme për hulumtimin, planifikimin, projektimin dhe rregullimin e fazave të inxhinierisë së trafikut dhe janë përdorur edhe në përcaktimin e prioriteteve dhe oraret e përmirësimeve të trafikut. Inxhinieri i trafikut duhet të marrin njohuri të përgjithshme të karakteristikave të vëllimit të trafikut për të matur dhe për të kuptuar përmasat, përbërjen, dhe kohën për shpërndarjen në rrugë të vëllimit për çdo zonë nën juridiksionin e tij.

Numërimet dhe anketimet në komunikacion janë mjetet e marrjes së informacionit në lidhje me trafikun. Kjo është një mënyrë sistematike e mbledhjes së të dhënave që do të përdoret për qëllime të ndryshme në inxhinierinë e trafikut.

Duke pasur parasysh shkallën e lartë të motorizimit dhe infrastrukturën aktuale nëpër rrugët e Kosovës, është me rëndësi të veçantë të jepet analizë e detajuar lidhur me qarkullimin e automjeteve.

Me rritjen e shkallës së motorizimit në komunikacion vjen deri të zvogëlimi i sigurisë në trafik, ngulfatja e trafikut, ndotja e ambientit etj.

Një vëmendje e veçante duhet ti kushtohet kontrollit të kryqëzimeve, sepse nëse ato janë mirë të projektuara, mund të paraqesin një përmirësim të qarkullimit. Në fakt kryqëzimet e rrjetit rrugor janë ato vende ku lindin konflikte midis rrymave të ndryshme të trafikut, që sjellin vonesa ashtu edhe aksidente, duke ulur nivelin e shërbimit dhe sigurinë e tyre.

Në këtë punim, do të bëhet shqyrtimi i rrugëve (kryqëzimeve) në hyrje të qytetit të Podujevës, konkretisht në rrjetin e rrugëve: Rruga “Skënderbeu”, Rruga “Zahir Pajaziti”, “Rruga Brigadat”, “Rruga e Xhamisë” dhe Rruga "Ramë Obranqa".

1.1. Pozita gjeografike

Komuna e Podujevës shtrihet në pjesën veri-lindore të Kosovës dhe përbëhet nga fushëgropa e Llapit, pjesët kodrinore-malore të malit të Albanikut në perëndim dhe maleve lindore kosovare në lindje. Qyteti i Podujevës shtrihet në të dy anët e lumit Llap. Komuna e Podujevës përbëhet nga 78 fshatra, duke përfshirë edhe qytetin e Podujevës. Në aspektin komunikativ paraqet një transversale të rëndësishme përmes së cilës kalon magjistranja që lidh Kosovën me pjesët tjera të Gadishullit Ilirik (Ballkanik). Kufizohet me pesë komuna të tjera. Komuna ka një pozitë me të vërtetë strategjike dhe ka lidhje të rëndësishme transporti: autostradën dhe hekurudhën rajonale. Aeroporti është vetëm 40 km larg nga komuna, ndërsa në komunë është liqeni më i madh në Kosovë, Liqeni i Batllavës.

Komuna e Podujevës si tersi ndahet ne tri zona kryesore, Figura 1.1:

- Zona Qendrore,
- Zona Veri-Perëndimore dhe
- Zona Lindore.




Figura 1.1: Harta e Podujevës [1]
(Burimi: Faqja zyrtare, Komuna e Podujevës)

Rrjeti i rrugëve në komunën e Podujevës përbëhet nga:

- **Rrugë nacionale - M25** - (Prishtinë - Merdare).
- **Rrugë regjionale** - (**R129** Podujevë - Mitrovicë, **R128** Podujevë – Vushtrri, **R126** Podujevë - Pollatë, **R125** Podujevë - Orllan, **R127** Podujevë - Perpellac).
- **Rrugë lokale** dhe
- **Rrugë të pa kategorizuara.**

Në Tabelën 1.1 është dhënë shtrirja e rrjetit rrugor në komunën e Podujevës [1].

Tabela 1.1: Gjatësia dhe përqindja e rrugëve në komunën e Podujevës

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia në km	%
1	Rrugë nacionale	18.8	1.53
2	Rrugë regjionale	80	6.53
3	Rrugë lokale	370.1	30.21
4	Rrugë të pakategorizuara	756.3	61.73
	Gjithsej	1225	100

1.2. Demografia

Sipas regjistrimit të vitit 1981 Komuna e Podujevës kishte 127 376 banor, me regjistrimin e vitit 2011 janë evidentuar 88 499 banorë, që nënkupton 38.000 ose 30% më pak se në vitin 1981.

Shumica e popullsisë (64.5%) jeton në fshat, ndërsa (35.5%) e saj jeton në qytet, respektivisht në qendrën e vetme, që është Podujeva.

Dendësia mesatare e banimit në nivel të komunës arrin në 139 banorë në një km², kurse në vendbanimet rurale është 130.7 banorë në km². Hapësirat me dendësi më të madhe janë rreth qendrës komunale dhe në zonën e rrafshët, ku dendësia e banimit arrin mbi 500 banorë në km² dhe kështu tejkalon mesataren e dendësisë së hapësirës së Komunës.¹

1.3. Qëllimi i punimit

Në këtë punim diplome master është bërë shqyrtimi i rrugëve në hyrje të qytetit të Podujevës, konkretisht në rrjetin e rrugëve: Rruga “Skënderbeu”, Rruga “Zahir Pajaziti”, “Rruga Brigadat”, “Rruga e Xhamisë” dhe Rruga “Ramë Obranqa” (Figura 1.2 dhe 1.3), që krijojnë një rrjet rrugësh shumë të ngarkuara si me automjete ashtu edhe me këmbësorë. Kjo ka imponuar nevojën për ta studiuar me qëllim të analizës së problemeve të komunikacionit dhe gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme apo optimale.

Qëllimi i temës është që në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse të bëhet analiza e këtij rrjeti rrugor bazuar në të dhënat e mbledhura nga gjendja ekzistuese në teren për secilën nyje, futja e të dhënave në softuer, krijimin e modelit kompjuterik - grafik në bazë të të dhënave, aplikimi i simulimit, dhe të jepen propozimet e zgjedhjeve më të mira. Qëllimi është që me anë të softuerit të sofistikuar për analizë të trafikut të krijohet modeli i rrjetit rrugor të shqyrtuar me qëllim të

¹ <https://kk.rks-gov.net/podujeve>

zgjedhjes së problemeve të identifikuara në komunikacion. Studimi bëhet për orët e pikut (kulmore) të qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve.

Rrjeti rrugor i shqyrtuar në hulumtimin tonë përbëhet prej këtyre llojeve të udhëkryqeve:

- Një udhëkryq me rrethrotullim dhe
- Dy udhëkryqe klasike të formës “T”.




Figura 1.2: Harta e rrjetit rrugor e marrë për shqyrtim në qytetin e Podujevës (Burimi: Google Maps)



Figura 1.3: Pamja nga lartë e rrjetit rrugor e marrë nga Gjeoportali

1.4. Identifikimi dhe përshkrimi i problemit

Me rritjen e numrit të automjeteve automatikisht ndodh zvogëlimi i kapacitetit dhe nivelit të shërbimit, ulja e shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve, numrin e madh të aksidenteve dhe zvogëlim të shkallës së sigurisë. Përgjatë kohës së vëzhgimeve në teren në këtë segment rrugor janë vërejtur bllokime të vazhdueshme të trafikut nëpër udhëkryqe. Pas analizës së gjendjes aktuale do të propozohet varianti më i mirë për zgjidhjen e problemit të qarkullimit të automjeteve. Në këtë aspekt është me rëndësi të bëhet analiza e kapacitetit dhe nivelit të shërbimit të rrugëve në mënyrë që të identifikohen faktorët kyç që kanë ndikim në të dhe pastaj të intervenohet në përmirësimin e tyre. Duke i analizuar të gjitha këto probleme që janë duke u ballafaquar pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor është e nevojshme që të bëhet një studim më i gjërë në këto udhëkryqe te qytetit te Podujevës.

Prandaj sa i përket problemit të qarkullimit të automjeteve ne do mundohem të ofrojmë zgjidhje përmes ndryshimeve të udhëkryqeve pa sinjalizim ndriçues ne atë me sinjalizim ndriçues apo me rrethrotullim, si dhe ne baze të mundësive ne rritjen e numrit të shiritave për kahje. Në Figurën 1.4, 1.5 dhe 1.6 është paraqitur gjendja ekzistuese e udhëkryqeve që do të analizohen.



Figura 1.4: Pamje nga gjendja ekzistuese e rrethrotullimit në rrugën “Skënderbeu”



Figura 1.5: Pamje nga gjendja ekzistuese e udhëkryqit në Rr. “Zahir Pajaziti”






Figura 1.6: Pamja nga gjendja ekzistuese e udhëkryqit ne Rr. “Brigadat”

2. KUPTIMI I TEKNIKËS SË TRAFIKUT RRUGOR

Teknika e trafikut është dega e inxhinierisë që merret me aplikimin e teknologjisë, njohurive inxhinierike dhe parimeve shkencore në planifikimin, projektimin dhe dizajnimin gjeometrik të trafikut, si dhe operacionet e trafikut të rrugëve për automjete, nyjet rrugore, rrugët përcjellëse, autostradat, rrjetet e rrugëve, vend parkimet, sinjalizimet, terminalët, aplikimin e sistemeve të informimit dhe marrëdhëniet e tyre me mënyrat e tjera të transportit për arritjen e lëvizjes së sigurt, efikase dhe të përshtatshëm të njerëzve dhe mallrave.

Teknika e trafikut fokusohet kryesisht në hulumtimin për një qarkullim të sigurt dhe efikas të trafikut rrugor, siç janë: gjeometria e rrugëve, lëvizja e automjeteve, hapësirat e lëvizjes së kalimtarëve, hapësirat e lëvizjes së biçiklistëve, sinjalizimet e trafikut, shenjat e sinjalizimit horizontal (shenjat në rrugë), sinjalizimin ndriçues, sistemet e sigurisë në trafik, sjelljet e shoferëve, ndërveprimi me sistemet tjera të transportit veçanërisht atë hekurudhor.

Teknika e trafikut zbaton parimet e inxhinierisë që të ndihmojë zgjidhjen e problemeve të transportit duke marrë parasysh psikologjinë dhe sjelljet e përdoruesve të sistemit të transportit.

Një nga pengesat më të mëdha për një inxhinier profesional trafiku është në zbatimin e parimeve të shëndosha të teknikës së trafikut duke konkurruar teoritë e inxhinierëve dhe ekspertëve që nuk janë ekspertë të trafikut. Rezultati i pafat është krijimi i rreziqeve të trafikut kur teoritë e gabuara janë vënë në fuqi. Sa herë që kontrollet e panevojshme apo të tepruara të trafikut aplikohen, zakonisht rezultojnë me kushtet e rrezikshme të trafikut.

Teknika e trafikut është ngushtë e lidhur me këto veprimtari:

- *Inxhinierinë e transportit,*
- *Inxhinierinë e ndërtimit të rrugëve,*
- *Inxhinierinë e lëvizjes me biçikleta,*
- *Inxhinierisë së autostradave,*
- *Planifikimi urban,*
- *Inxhinieria e faktorëve human dhe*
- *Teknologjia e telekomunikimit dhe informimit,*

Menaxhimi i qarkullimit të trafikut - mund të jetë i përkohshëm (duke përgatitur projektim të planeve për kontrollin e trafikut, duke përfshirë edhe plane për devijime për automjete dhe kalimtarë), ose i përhershëm (parashikimi i ndikimeve të planeve të propozuara në trafik).

2.1. Aktivitetet përbërëse të teknikës së trafikut

Ka një numër të aktiviteteve përbërëse të teknikës së trafikut:

- *Studimet e trafikut dhe karakteristikat,*
- *Vlerësimi i performancës së trafikut,*
- *Dizajni i objekteve dhe sistemeve të trafikut,*
- *Kontrolli i trafikut,*
- *Operacionet e trafikut,*
- *Menaxhimi i sistemeve të transportit,*
- *Sistemet informative të aplikuara në trafik dhe të transportit.*

Studimet e trafikut dhe karakteristikat - përfshijnë matjen dhe kuantifikimin e aspekteve të ndryshme të trafikut të rrugëve. Studimet përqendrohen në mbledhjen e të dhënave dhe analiza që përdoren për të karakterizuar trafikun, duke përfshirë (por jo të kufizuar) në vëllimet e trafikut dhe kërkesat, shpejtësinë dhe kohën e udhëtimit, vonesat, aksidentet, origjinën dhe destinacionin, përdorimet modale, dhe variabla të tjera.

Vlerësimi i performancës - është një mënyrë me të cilin inxhinierët e trafikut mund të vlerësojnë dhe shkallëzojnë karakteristikat operative të seksioneve të veçanta të objekteve të trafikut, dhe atyre objekteve si një e tërë në terma relativë. Një vlerësim i tillë mbështetet në masat e cilësisë së performancës dhe është thënë shpesh në kuptim të "*niveleve të shërbimit*". Nivelet e shërbimit janë si notat në shkronja, nga A deri F, duke përshkruar se sa mirë një sistem trafiku është duke vepruar duke përdorur kriteret e përcaktuara të performancës.

Dizajni i objekteve dhe sistemeve të trafikut - involvon inxhinierët të trafikut në hartimin funksional dhe gjeometrik të rrugëve, autostradave dhe objekteve të tjera të trafikut. Inxhinierët e trafikut mund të mos jenë të përfshirë në projektimin strukturor të objekteve të trafikut, por duhet të kenë njohuri dhe vlerësim për karakteristikat strukturore të objekteve të trafikut që i kanë në përgjegjësi.

Kontrolli i trafikut - është një funksion qendror i inxhinierëve të trafikut dhe përfshin krijimin e rregullave të trafikut dhe komunikimin e tyre tek shoferi nëpërmjet përdorimit të pajisjeve të kontrollit të trafikut, të tilla si shenjat, shënimet në rrugë, sinjalet dhe mënyrat e telekomunikimit.

Operacionet e trafikut - përfshin masat që ndikojnë në funksionimin e përgjithshëm të sistemeve të trafikut, të tilla si sistemet e rrugës me një apo shumë korsi, operacionet e transitit, menaxhimin e kufizimeve dhe mbikëqyrjen e sistemeve të kontrollit të rrjetit të trafikut.

Menaxhimi i sistemeve të transportit (TMS) - përfshin pothuajse të gjitha aspektet e teknikës së trafikut në një fokus për të optimizuar kapacitetin dhe operacionet e sistemit të trafikut. Aspekte të veçanta të TMS përfshijnë sistemet prioritare të stërngarkuara të automjeteve (trafikun me ngarkese të madhe), programet e analizës së rrjetit të trafikut, strategjitë e çmimeve për të menaxhuar kërkesën, dhe funksione të ngjashme.

Sistemet informative të aplikuara në trafik dhe transport - i referohet aplikimit të teknologjisë moderne të telekomunikacionit në funksionimin dhe kontrollin e sistemeve të transportit. Sistemet e tilla përfshijnë rrugë për lëvizje të automatizuara, sisteme të automatizuara të taksës rrugore, sisteme të automatizuara të parkingut, sisteme të automatizuara

të lëvizjes së automjeteve, automjet me GPS dhe hartës së sistemeve - GIS, zbatimit të automatizuar të semaforëve dhe ligjeve për shpejtësi, pajisje të kontrollit të mençur, softuerë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, senzore për përcjellje të trafikut, senzore për numërim etj. Kjo është një sistem i madh në zhvillim të shpejtë të teknologjive me potencial për të ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si udhëtohet në trafik, si dhe mënyrën në të cilën profesionistët e transportit mbledhin informacionit dhe kontrollojnë sistemet e trafikut.

2.2. Inxhinierët e trafikut

Inxhinierët e trafikut janë profesionistët që angazhohen për gjendje më të sigurtë të trafikut duke ofruar kushte në rrugë që mundësojnë një qarkullim të mirë dhe efikas të trafikut. Si profesionistë të trajnuar, ata përcjellin dhe evidentojnë dukuritë dhe kushtet e trafikut, dhe për të dhënë vlerësimet e argumentuara, ata bëjnë numërimet në trafik, analizojnë statistikën e aksidenteve, studiojnë të dhënat e shpejtësisë, ekzaminonë kushtet në rrugë dhe gjendjen e rrugëve, realizojnë hulumtime të trafikut, studiojnë të arriturat e profesioneve tjera që ndërlihen me trafikun, etj.

Vendimet për opsionet dhe ndryshimet që ata duhet të japin duhet të jenë profesionale, që mund të jenë të lehta dhe të shpejta por edhe të vështira, të shtrenjta, të gjata dhe me pengesa të mëdha. Teknika e trafikut involvon një varietet të aftësive inxhinierike dhe menaxheriale të inxhinierëve, ku përfshihen: *planifikimi, menaxhmenti, dizajni, projektimi, konstruktimi, operacionet, kontrolli, mirëmbajtja dhe optimizimi i sistemeve të trafikut.*

2.3. Karakteristikat e trafikut

Përveç pjesëmarrësve në trafik, dhe gjeometrisë së rrugëve, trafiku ka karakteristikat tjera kryesore që janë të nevojshme për llogaritje, analiza dhe rezultate.

Këto karakteristika janë:

- *Vëllimi,*
- *Kërkesa,*
- *Shkalla e qarkullimit,*
- *Kapaciteti,*
- *Niveli i shërbimit,*

Ndonjëherë këta parametra përdoren në relacion me parametrat tjera apo konditat tjera. Këta katër parametra janë të ndërlidhur dhe të gjithë janë të shprehur me njësi të njëjta apo të ngjashme. Njohja e këtyre parametrave mundëson njohjen e ligjshmërive të trafikut në varësi të llojit të infrastrukturës, ndarjes territorial, specializimit etj.

Matja e këtyre parametrave veçmas varet nga automjetet në lokacionet e studiuara të trafikut, që mund të jenë rrugë urbane, autostradë, rrugë rurale, kryqëzime, rrethrotullim, etj. Nëse automjetet janë numëruar në çfarëdo lokacioni të definuar për një orë, atëherë:

Vëllimi - do të jetë numri i automjeteve të numëruara që kalojnë lokacionin që studiohet për një orë (aut/h),

Kërkesa – do të jetë vëllimi plus automjetet që kërkojnë të kalojnë pjesën e rrugës që studiohet për një orë, dhe të cilët janë mohuar ta bëjnë këtë për shkak të tollovisë. Më vonë mund të përfshijë motoristët në rend të pritjes të cilët presin të arrijnë lokacionin e studiuar,

shoferët dhe motoristët që përdorin marshuta alternative për të evituar tollovitë rreth lokacionit të studiuar, dhe shoferët që vendosin mos me udhëtua për shkak të tollovisë së madhe. Në parim, kërkesa ndërlihet me automjetet që arrijnë në pikën e matjes, ndërsa vëllimi ndërlihet me automjetet që kalojnë pikën e matur,

Shkalla e qarkullimit – Paraqet shkallën në të cilën automjetet (ose personat) kalojnë në pikën e shikuar gjatë një periudhe të caktuar kohore për më pak se një orë, të shprehur si një ekuivalent i shkallës në orë,

Kapaciteti – paraqet shkallën maksimale në të cilën automjetet mund të kalojnë një pikë apo një segment të shkurtë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Paraqet karakteristikën e rrugës së automjeteve. Vëllimi aktual kurrë nuk mund të evidentohet në nivelet më të larta se kapaciteti i vërtetë i seksionit. Por, rezultatet e tilla mund të paraqiten për shkak se kapaciteti shpesh është parashikuar duke përdorur procedura standarde të analizave. Këto parashikime mund të ndodh që të jenë shumë të ulta për disa lokacione,

Niveli i shërbimit – Paraqet parametrin kualitativ që përdoret për të definuar kualitetin e shërbimeve të trafikut.

Në manualin *HCM – Highway Capacity Manual* (Manuali i kapacitetit të rrugëve)[2] , është i definuar raportin *V/C – Volume-Demand-to-Capacity Ratio*, që paraqet raportin në mes të vëllimit të trafikut në një orë të pjesëtuar me kapacitetin e rrugës. Ky parametër është i rëndësishëm dhe përdoret për planifikim të trafikut edhe krijim të tabelave të *V/C* në raport me nivelin e shërbimit të komponentës së trafikut. Ky është parametër matës që tregon mobilitetin dhe kualitetin e lëvizjes në rrugë apo sektor të rrugës. Nëse v/c është 1.00, kjo tregon se rruga po operon në kapacitet të saj. Në Tabelën 3.1 janë treguar vlerat parametrin v/c në raport me gjendjen e tollovi në trafik:

Tabela 2.1: Vlerat parametrin v/c

Shkalla e V/C	Niveli i tollovisë në trafik
1.00	Tollovi shumë e rëndë. Trafik i bllokuar
0.75-1.0	Tollovi e rëndë
0.5-0.74	Tollovi mesatare
< 0.5	Tollovi e vogël, ose pa tollovi

2.4. Jolineariteti kohor i qarkullimit të automjeteve

Shikuar kronologjikisht për njësitë e njëjta kohore në prerjen apo në pjesën e rrugës në kushte reale, qarkullimi i automjeteve është madhësi e ndryshueshme e kushtëzuar nga faktorë të shumtë të cilët për nga karakteri i tyre janë po ashtu të ndryshueshëm.

Jolineariteti i qarkullimit të automjeteve në ndonjë pjesë të rrjetit mund të shkaktohet edhe si rezultat i ç'rregullimeve siç janë, p.sh. fytet e ngushta, problemet kohore dhe ato klimatike e të ngjashme, që do të thotë se disa faktorë që ndikojnë në jolinearitetin e qarkullimit kanë karakter të ndryshoreve të rastit.

Për shkak të rëndësisë së madhe të jolinearitetit të qarkullimit të automjeteve, për vendime praktike në procesin e planifikimit të rrugëve të komunikacionit, që nga faza të hershme të zhvillimit të motorizimit, përpjekjet e eksperteve kanë qenë të orientuara drejt njohjes sa më të mirë të ligjshmërive të jolinearitetit të qarkullimit të automjeteve.

Për nevoja praktike janë të rëndësisë së veçantë karakteristikat e jolinearitetit kohorë të qarkullimit të automjeteve, të cilat në masë të caktuar janë të lidhura me ciklet e paraqitjes së kërkesave për transportin e njerëzve dhe të mirave materiale.

Ligjshmëritë e jolinearitetit kohorë të qarkullimit të automjeteve nga ky aspekt paraqiten përmes jolinearitetit:

- Në orë në periudhë një ditore (24orë)
- Në orë në periudhë e një viti të tërë (8760orë)
- Ditor në periudhë njëjavore (shtatë dite)
- Ditor në periudhë njëmuajore
- Ditor në periudhë prej një viti të tërë dhe
- Mujor në periudhën e një viti të tërë

2.5. Jolineariteti në orë i qarkullimit të automjeteve në periudhën njëditore

Paraqet ndryshueshmërinë e qarkullimit në orë të caktuar në periudhën e një dite të tërë, apo në periudhën 24 orë. Ky jolinearitet paraqitet me raportin mes qarkullimit në orë të caktuara dhe qarkullimit mesatar të shprehur në orë në periudhë të ditës së tërë.

$$F_{ai} = \frac{q_i}{q}, \quad F_{ai} > 1, \quad i = 1, 2, \dots, 24 \quad (2.1)$$

Meqenëse:

$$q = \frac{\sum_{i=1}^{24} q_i}{24}, \text{ atëherë kemi: } F_{ai} = \frac{24 \cdot q_i}{\sum_{i=1}^{24} q_i} \quad (2.2)$$

2.6. Jolineariteti ditor i qarkullimit në periudhë prej shtatë ditësh

Jolineariteti ditor i qarkullimit në periudhë prej shtatë ditësh, paraqet ndryshimin e qarkullimit të automjeteve në secilën ditë në periudhën prej shtatë ditësh. Ky jolinearitet paraqitet me faktorin f_{ci} si raport ndërmjet qarkullimit të automjeteve për secilën ditë dhe qarkullimit mesatar ditor në periudhën shtatë ditore [3].

$$f_{ci} = \frac{KD_i}{KMD_7}, \quad f_{ci} \geq 1, \quad i = 1, 2, \dots, 7 \quad (2.3)$$

Meqenëse:

$$KMD_7 = \frac{\sum_{i=1}^7 KD_i}{7}, \text{ atëherë: } f_{ci} = \frac{7KD_i}{\sum_{i=1}^7 KD_i} \quad (2.4)$$

Ku janë:

- KD - komunikacioni ditor,
- KMD - komunikacioni mesatar ditor.

2.7. Numërimet përkatëse të qarkullimeve

Incizimi respektivisht numërimi në trafik është bazë e planifikimit të qarkullimit. Me të fitohet një pasqyrë mbi gjendjen momentale të qarkullimit në trafik, prej nga mund të rezultojnë nevojat aktuale për rikonstruktim, ndërtim të drejtimeve të reja në trafik apo masa tjera për përmisimin e qarkullimit ekzistues.

Ekzistojnë shumë metoda të incizimeve, mes të cilave do ti përmendim:

- Metoda e shënimit në formularë,
- Metoda e shënimit të shenjave të regjistrimit,
- Metoda e shënimeve nëpërmjet të tiketave,
- Metoda e ekzaminimeve të rrugës,
- Metoda e shenjave të numërimit,
- Metoda elektromekanike sipas PREDEL-it (Prädel).

Në këtë punim diplome master numërimi është bërë me metodën e shënimit në formularë.

Numërimi është bërë për shtatë ditët e javës në dy periudha kohore, në periudhën **12:30-13:30 dhe 17:00-18:00**, pasi që në këto periudha ka pas qarkullim më të madhë të automjeteve dhe këmbësorëve.

Në Tabelën 2.2 është paraqitur numri i qarkullimit të automjeteve për udhëkryqin e shqyrtuar me rrethrotullim në hyrje të Podujevës nga drejtimi i Prishtinës.

Tabela 2.2: Numri i qarkullimit të automjeteve për orët dhe datën e vëzhguar

Dita/Data e numërimit	Koha e matjeve	
	12:30-13:30	17:00-18:00
	Aut / h	
E hënë / 14.12.2020	1690	1587
E martë / 15.12.2020	1578	1450
E mërkurë / 16.12.2020	1472	1495
E enjte / 17.12.2020	1620	1450
E premte / 18.12.2020	2014	1527
E shtunë / 19.12.2020	1580	1605
E diele / 20.12.2020	700	659

Në Figurën 2.1 është paraqitur jolineariteti javor i qarkullimit të automjeteve për udhëkryqin e shqyrtuar me rrethrotullim në hyrje të qytetit të Podujevës.




Figura 2.1: Jolineariteti ditor i qarkullimit të automjeteve në periudhë prej shtatë ditësh në intervalin kohor

Duke u bazua në të dhënat e fituara në mënyrë tabelare dhe grafike vërejmë se ditët më të ngarkuara me qarkullim të automjeteve janë: dita e hënë, dita e premte dhe dita e shtune.

Dhe në bazë të këtyre të dhënave do të bëhen llogaritjet e kapacitetit dhe nivelit të shërbimit për udhëkryqet e marra për analizë.

2.8. Niveli i shërbimit

Niveli i shërbimit paraqet përmasën kualitative, e cila karakterizon kushtet e qarkullimit në rrugë. Përshkrimi i niveleve të shërbimeve individuale i karakterizon këto kushte me ndihmën e tregueseve, siç janë: shpejtësia dhe koha e udhëtimit, pengesat në komunikacion, liria e manovrimit, komforti dhe komoditeti, etj.

Koncepti i niveli të shërbimit të rrugëve përdoret për të përkufizuar cilësinë dhe lehtësinë e lëvizjes në kushte të ndryshëm të trafikut, si dhe kushtet e kontrollit të tij. Përdorimi i shkallëzimit me germa nga A në F është një rregull i përgjithshëm për të përshkruar këto kushte.

Niveli i shërbimit, ose i shënuar ndryshe me LOS (level of service), është një masë cilësie e cila përshkruan kushtet e operimit në një rrymë trafiku, përgjithësisht në termat e masave të shërbimit siç janë shpejtësia dhe koha e udhëtimit, liria e lëvizjes, ndërprerja e trafikut, komforti dhe kursimi.

Niveli i shërbimit mat cilësinë e kushteve të operimit në një sistem trafiku dhe mënyrën sesi këto kushte janë perceptuar nga drejtuesit e mjeteve dhe pasagjerët. Shpejtësi-qarkullim-dendësi në trafik janë një marrëdhënie e rëndësishme e cila ndikon në nivelin e shërbimit në kushte ideale të lëvizjes.

Për një rrugë të dhënë, kapaciteti i saj mund të jetë konstant. Qarkullimi aktual mund të ndryshojë nga dita në ditë dhe në orare të ndryshëm të së njëjtës ditë. Qëllimi i nivelit të shërbimit është të lidhë cilësinë e shërbimit të trafikut mbi një fluks të rrjetit rrugor të dhënë. Niveli i shërbimit ndahet në gjashtë nivele. Niveli A përfaqëson kushtet më të mira të trafikut në të cilin drejtuesit kanë të gjithë lirinë të lëvizin me shpejtësinë që dëshirojnë një qarkullim të lirë, dhe niveli F përfaqëson cilësinë e kushteve më të këqija të trafikut [2].

- Niveli i shërbimit A përfaqëson kushtet e fluksit të lire në të cilin trafiku virtualisht është zero dhe mjeti ka të gjitha mundësitë e manovrimit,
- Niveli i shërbimit B përfaqëson kushtet e fluksit me ndonjë kufizim në lirinë e manovrimit, por me kushte të shumë të mira të komfortit fizik dhe psikologjik
- Niveli i shërbimit C përfaqëson kushtet stabile të fluksit në të cilin për të mbajtur shpejtësinë e dëshiruar, duhet të ndërrohet shiriti ose të realizosh parakalime që kërkojnë vëmendje nga ana e drejtuesit të mjetit,
- Niveli i shërbimit D karakterizohet nga një fluks mjetesh i stabilizuar, por mundësia e manovrimit është shumë e kufizuar dhe është ulur niveli i komfortit fizik dhe psikologjik,
- Niveli i shërbimit E karakterizohet nga një nivel i ulët i shërbimit dhe korrespondon me kapacitetin e rrugës. Kufizimet e manovrave midis mjeteve arrijnë vlerën maksimale dhe nivelet e komfortit fizik dhe psikologjik janë në vlerat më të ulëta,
- Niveli i shërbimit F përfaqëson kushtet e qarkullimit me ndërprerje dhe bllokime të shpeshta të tipit ndalo dhe ec.

Tabela 3.2: Niveli i shërbimit

NSH (Niveli i shërbimit)	Kryqëzim i sinjalizuar	Kryqëzim i pa sinjalizuar
A	≤ 10 s	≤ 10 s
B	10–20 s	10–15 s
C	20–35 s	15–25 s
D	35–55 s	25–35 s
E	55–80 s	35–50 s
F	≥ 80 s	≥ 50 s

3. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR UDHËKRYQET

Udhëkryqet janë nyje të rrjetit rrugor në të cilat bëhet lidhja e ndërsjellët e llojeve dhe e tipave të ndryshëm funksional të rrugëve dhe njëkohësisht përmes kontrollit të qasjes dhe distancës së ndërsjellët të udhëkryqeve, sipas kushteve programore për projektim, sigurohet ruajtja e nivelit të caktuar të shërbimit të rrugëve urbane. Mbi të gjitha në hapësirën urbane, ku densiteti i udhëkryqeve është rritur, kostot e dukshme të realizimit dhe impaktin mbi ambientin, përjashtohen, vetëm në raste të veçanta, realizimin e udhëkryqeve në disnivel, ose atyre udhëkryqeve rrethor. Rritja e sigurisë në udhëkryqe, duke zvogëluar pikat e konfliktit ndërmjet automjeteve mundëson edhe:

- *Zvogëlimin e vonesave të pritjes në udhëkryqe,*
- *Zvogëlimin e gjatësisë së radhëve të pritjes,*
- *Sigurimin e përparësisë në grupe të veçanta, p.sh. automjetet të transportit kolektiv ose të këmbësorëve,*
- *Zvogëlimin, të paktën në mënyrë indirekte, të konsumit të karburantit dhe emetimit të ndotësve të ambient.*

Udhëkryqet në rrjetin rrugor janë pikat e takimit të segmenteve të ndryshme të rrugëve. Llojet e udhëkryqeve janë:

- *Udhëkryq në nivel me rregulla përparësie (djathtas),*
- *Udhëkryq në nivel me rregulla përparësie (sinjalizimi fiks),*
- *Udhëkryqet rrethore,*
- *Udhëkryqet me semafor dhe*
- *Udhëkryqet me disnivele.*

3.1. Kapaciteti dhe niveli i shërbimit për udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues

Në një udhëkryq pa sinjalizim ndriçues ose me prioritet, konfliktet zgjidhen nga rregulla të përgjithshme ose nga rregulla të vendosura me sinjalizim përkatës horizontal dhe vertikal, përkatësisht siç është dhënia e përparësisë apo shenjat e ndaljes, respektivisht të kryqëzimit me rrugë me përparësi kalimi. Lëvizjet e rangut më të ulët duhet tu japin përparësi lëvizjeve të rangut më të lartë.

Lëvizjet drejt dhe djathtas nga rruga kryesore duhet të jenë lëvizje me përparësi kalimi. Prandaj, këto lëvizje kanë fluks më të madh të qarkullimit në raport me flukset tjera të qarkullimit dhe normalisht nuk ngadalësohen dhe nuk kanë humbje kohore në hyrje të udhëkryqit.

Në anën tjetër, lëvizjet majtas nga rruga kryesore dhe ato nga rrugët dytësore do të duhet tu japin përparësi qarkullimeve nga rruga kryesore. Sa më shumë automjete të kenë prioritet aq më i vogël do të jetë kapaciteti për lëvizje të automjeteve nga rangu më i ulët.

Në udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues kapaciteti dhe niveli i shërbimit mund të llogaritet për një shirit ose grup shiritash. Megjithatë, termi “kapaciteti i udhëkryqit” kryesisht nuk ka domethënie praktike, duke qenë se shiritat mund të mbajnë kapacitet rezervë që mund të mos përdoret për shkak të shpërndarjes së qarkullimit. Ajo që ka rëndësi në praktikë në udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues është llogaritja e kapacitetit potencial të lëvizjeve nga rangu më i ulët.

3.2. Analiza e kapacitetit në udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues

Analiza e kapacitetit në udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues varet nga përshkrimi i saktë dhe kuptimi i interaksionit të ngasësit i cili kyçet në udhëkryq nga hyrja anësore dhe atij nga drejtimi kryesor.

Procedura e dhënë në këtë rast bazohet në modelin e pranuar të intervalit të përcjelljes. Ngasësi i cili kyçet në udhëkryq nga hyrja anësore duhet të përcaktoj se kur intervali kohorë i përcjelljes ndërmjet automjeteve në drejtimin kryesor është i mjaftueshëm të ndërmarrë lëvizjen nëpër udhëkryq dhe kur është momenti për një veprim të tillë.

Duhet pasur parasysh se janë marrë në konsideratë llojet e automjeteve (struktura) dhe madhësia e pjerrtësisë gjatësore, ashtu që edhe automjetet e udhëtarëve nëse lëvizin në pjerrtësi gjatësore duhet shndërruar në njësi aut (automjete të udhëtarëve).

3.3. Hapat metodologjik themelor gjatë analizës së kapacitetit dhe nivelit të shërbimit në udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues

- *Përdorimi i metodologjisë për analizimin e kapacitetit dhe nivelit të shërbimit në udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues bazohet në këta hapa:*
- *Përcaktimi i kushteve ekzistuese gjeometrike dhe të komunikacionit për udhëkryqin e vështruar,*
- *Përcaktimi i qarkullimeve konfliktuoz nëpër të cilat automjetet duhet të kalojnë (kthimet majtas nga drejtimi kryesor dhe të gjitha lëvizjet nga drejtimet dytësore),*
- *Përcaktimi i madhësisë së intervalit të përcjelljes në qarkullimin konfliktuoz (e nevojshme për automjetet të cilat lëvizin nga drejtimet dytësore),*
- *Përcaktimi i kapacitetit potencial në bazë të intervalit të përcjelljes në qarkullimin kryesor,*
- *Përshtatja e kapacitetit potencial të llogaritur në kushte të vështirësuar dhe përdorimin e shiritit të përbashkët,*
- *Përcaktimi i kohës potenciale të humbur për të gjitha lëvizjet dhe në bazë të kësaj përcaktimi i nivelit të shërbimit për secilin drejtim në veçanti.*

3.4. Të dhënat e nevojshme hyrëse

Të dhënat e kërkuara hyrëse për udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues janë të ngjashme me të dhënat të cilat shfrytëzohen për analizën e kapacitetit dhe nivelit të shërbimeve të pjesët tjera funksionale të rrjetit rrugor.

Është i nevojshëm përshkrimi detal i karakteristikave gjeometrike, regjimit të punës së udhëkryqit dhe të dhënat lidhur me qarkullimin e komunikacionit.

Faktorët gjeometrik kyç janë:

- *Numri dhe qëllimi i shiritave,*
- *Ndarja e qarkullimit dhe*
- *Pjerrtësia gjatësore e hyrjeve në udhëkryq.*

Secili nga këta faktorë ka ndikim të posaçëm në kapacitetin themelor, për secilën lëvizje nga rangu më i ulët, për madhësinë e dhëne të qarkullimit konfliktuoz. Numri dhe qëllimi i shiritave është faktor kritik. Automjetet në shiritat e ndarë mund të shfrytëzojnë intervalin e njëjtë të përcjelljes, mirëpo në rast se automjetet e ndajnë shiritin e përbashkët, atëherë vetëm një automjet mund të shfrytëzoj intervalin e përcjelljes.

Ndarja e qarkullimit është gjithashtu e rëndësishme, sepse zvogëlon interaksionin ndërmjet automjeteve me ndarjen e qarkullimeve konfliktuoz.

Pjerrtësia gjatësore në hyrje nga rruga dytësore ka ndikim direkt në kapacitet; tatëpjeta e rrit, ndërsa rënia e pjesës së rrugës e zvogëlon kapacitetin në hyrje të udhëkryqit.

Vlerat e qarkullimit të shprehura në (aut/h) shndërrohen në (aut/h) sipas ekuivalencës së dhënë në Tabelën 3.1:

Tabela 3.1: Ekuivalenca e automjeteve të udhëtarëve (aut)

Lloji i automjeteve	PGJ (%)				
	-4	-2	0	2	>2
Motoçikletat	0.3	0.4	0.5	0.6	0.7
Automjetet e udhëtarëve	0.8	0.9	1.0	1.2	1.4
Automjetet e rënda dhe autobusët	1.0	1.2	1.5	2.0	3.0
Autotrenat	1.2	1.5	2.0	3.0	6.0
Të gjitha automjeteve	0.6	1.0	1.1	1.4	1.7

Duhet theksuar se janë marrë parasysh llojet e automjeteve dhe madhësia e pjerrtësisë gjatësore, ashtu që edhe automjetet e udhëtarëve nëse lëvizin në pjerrtësi gjatësore duhet të shndërrohen në njësi të aut [3].

3.5. Qarkullimi konfliktuoz


Natyrë e lëvizjeve konfliktuoz në udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues është relativisht komplekse. Çdo lëvizjeje nga rangu më i ulët i kundërvihen qarkullimet e ndryshme konfliktuoz. Këto qarkullime konfliktuoz janë dhënë në Figurën 3.1.a dhe b dhe në Tabelën 3.2 në të cilën në mënyrë ilustruese janë shfaqur mënyrat e paraqitjes së parametrin $Q_{c,x}$ (aut/h), i cili paraqet qarkullimin konfliktuoz për lëvizjen x.

P.sh. kthimet djathtas nga drejtimet dytësore janë në konflikt me lëvizjet drejt dhe kthimet djathtas nga drejtimi kryesor. Në Tabelën 3.2 janë marrë në konsideratë vetëm gjysma e kthimit


djathtas nga drejtimi kryesor, sepse është vërtetuar se ngasësit nga drejtimi dytësor nuk janë plotësisht të sigurt se automjetet të cilat lëvizin nga drejtimi kryesor do të kthejnë djathtas apo do të vazhdojnë lëvizjen drejt. Lëvizjet majtas nga drejtimi kryesor janë në konflikt të plotë me lëvizjet drejt dhe djathtas nga drejtimi kryesor.

Lëvizjet drejt nga rruga dytësore janë në konflikt me të gjitha lëvizjet nga drejtimi kryesor. Në llogaritje janë marrë parasysh vetëm gjysma e kthimeve djathtas nga drejtimi kryesor për arsye të cekura më parë.

Lëvizjet majtas nga drejtimi dytësor janë manovrimet më të vështira në udhëkryqet pa sinjalizim ndriçues. Qarkullimet konfliktuozë përfshijnë të gjitha lëvizjet nga drejtimi kryesor dhe lëvizjet drejt dhe djathtas nga drejtimi dytësor. Vetëm gjysmë kthimet djathtas dhe lëvizjet drejt nga drejtimet dytësore llogariten si qarkullime konfliktuozë, sepse ato lëvizje kryesisht janë të kontrolluara me sinjalizimin “stop” dhe për atë arsye ndikimi i tyre në kthimet majtas është i zvogëluar [3].



a) udhëkryqi “+” në nivel



b) udhëkryqi i formës “T”

Figura 3.1: Qarkullimet konfliktuozë në udhëkryqe [3]

Tabela 3.2: Qarkullimet konfliktuozë [3]

Qarkullimet konfliktuozë për lëvizjet djathtas nga rruga dytësore		
Qarkullimi konfliktuoz: Q_c	$Q_{c,9} = \frac{1}{2} \cdot Q_3 + Q_2 \text{ (aut / h)}$	$Q_{c,12} = \frac{1}{2} \cdot Q_6 + Q_5 \text{ (aut / h)}$
Qarkullimet konfliktuozë për lëvizjet majtas nga rruga kryesore		
Qarkullimi konfliktuoz: Q_c	$Q_{c,4} = Q_2 + Q_3 \text{ (aut / h)}$	$Q_{c,1} = Q_5 + Q_6 \text{ (aut / h)}$
Qarkullimet konfliktuozë për lëvizjet drejt nga rruga dytësore		
Qarkullimi konfliktuoz: Q_c	$Q_{c,8} = \frac{1}{2} \cdot Q_3 + Q_2 + Q_1 + Q_6 + Q_5 + Q_4$	$Q_{c,8} = \frac{1}{2} \cdot Q_3 + Q_2 + Q_1 + Q_6 + Q_5 + Q_4 \text{ (aut / h)}$

Koha ndërmjet largimit nga vija “stop” të një automjeti nga drejtimi dytësor deri te largimi i automjetit tjetër nga drejtimi i njëjtë në kushte të vargut konstant është intervali kohorë - vonesa e automjetit me rastin e nisjes t_f . Vlerat e t_f dhe t_g janë dhëne në Tabelën 3.3 [3].

Tabela 3.3: vlera e t_f dhe t_g [3].

Manovrimi i automjetit	Intervali kritik t_g (s)		Intervali kohorë-vonesa gjatë nisjes, t_f [s]
	Rruga kryesore dyshiritore	Rruga kryesore treshiritore	
MAJTAS nga rruga kryesore	5.0	5.5	2.1
DJATHTAS nga rruga dytësore	5.5	5.5	2.6
DREJT nga rruga dytësore	6.0	6.5	3.3
MAJTAS nga rruga dytësore	6.5	7.0	3.4

3.6. Kapaciteti potencial i lëvizjes

Kapaciteti potencial i lëvizjes është shënuar me $C_{p,x}$ (për lëvizjen “x”) dhe definohet si kapacitet gjatë kushteve ideale të lëvizjes së veçantë duke marrë parasysh këto kushte:

- Nuk ka ndikim nga udhëkryqet fqinje,
- Të gjitha lëvizjet nga rrugët dytësore kanë shirit të veçantë, gjithashtu edhe në rrugën kryesore lëvizjet kthimet majtas kanë shirit të veçantë dhe

- Lëvizjet e rangut më të ulët janë të varura nga rangu më i lartë.

Kapaciteti potencial $C_{p,x}$ për qarkullimet nga hyrjet dytësore shprehet përmes formulës 3.1:

$$C_{p,x} = \frac{3600}{t_f} \cdot e^{-\frac{(\sum Q_{c,y})t_0}{3600}} \quad (3.1)$$

Ku janë:

$C_{p,x}$ – kapaciteti potencial i lëvizjeve nga rruga dytësore “X” (aut/h)

$Q_{c,y}$ - madhësia e qarkullimit konfliktuoz

$t_0 = t_g - \frac{t_f}{2}$ (s) – koha e humbur

t_g (s) – intervali kritik (intervali kohorë minimal i përcjelljes mes automjeteve)

t_f (s) – intervali kohorë (vonesa) gjatë nisjes

3.7. Kapaciteti i shiritit të përbashkët

Deri në këtë pikë të gjitha lëvizjet nga rrugët dytësore janë trajtuar me shirita të veçantë për secilin drejtim të lëvizjes, mirëpo në praktikë shpesh nuk kemi raste të tilla, sepse dy apo tri drejtime të lëvizjes shfrytëzojnë një shirit të vetëm. Pasojë e shfrytëzimit të një shiriti për më tepër lëvizje është që vetëm një automjet mund të shfrytëzoj intervalin e pranuar të përcjelljes, deri sa në rast të ekzistimit të shiritave të posaçëm për lëvizje më tepër automjete mund të shfrytëzojnë intervalin e njëjtë të përcjelljes.

Ekuacioni për llogaritjen e kapacitetit të shiritit të përbashkët është:

$$C_{SH} = \frac{Q_m + Q_d + Q_{dj}}{\left[\frac{Q_m}{C_{m,m}} \right] + \left[\frac{Q_d}{C_{m,d}} \right] + \left[\frac{Q_{dj}}{C_{m,dj}} \right]} \quad (3.2)$$

Ku janë:

C_{SH} – kapaciteti i shiritit të përbashkët (aut/h)

Q_m – qarkullimi i lëvizjeve majtas në shiritin e përbashkët (aut/h)

Q_d – qarkullimi i lëvizjeve drejt në shiritin e përbashkët (aut/h)

Q_{dj} – qarkullimi i lëvizjeve djathtas në shiritin e përbashkët (aut/h)

$C_{m,m}$ – kapaciteti i lëvizjeve majtas në shiritin e përbashkët (aut/h)

$C_{m,d}$ – kapaciteti i lëvizjeve drejt në shiritin e përbashkët (aut/h)

$C_{m,dj}$ – kapaciteti i lëvizjeve djathtas në shiritin e përbashkët (aut/h)

Nuk duhet harruar që metodologjia nënkupton shiritin ekskluziv për kthim majtas në rrugën kryesore. Në rast se në rrugën kryesore nuk ka shirit të posaçëm për kthim majtas janë të mundura humbjet kohore për lëvizjet drejt dhe kthimet djathtas në rrugën kryesore për shkak të pritjes së automjeteve të cilat kthejnë majtas. Në këtë rast besueshmëria që në rrugën kryesore të mos krijohet vargu i automjeteve llogaritet në këtë mënyrë:

$$p_{o,j}^* = 1 - \frac{1 - p_{0,j}}{1 - \left[\frac{Q_{i1}}{S_{i1}} + \frac{Q_{i2}}{S_{i2}} \right]} \quad (3.3)$$

Ku janë:

$j = 1; 4$ – simbolet e kthimeve majtas nga rruga kryesore

$i_1 = 2; 5$ – simbolet e lëvizjeve drejt në rrugën kryesore

$i_2 = 3; 6$ – simbolet e kthimeve djathtas nga rruga kryesore

S_{i1} – qarkullimi i ngopur për lëvizjet drejt në rrugën kryesore (aut/h)

S_{i2} – qarkullimi i ngopur për kthimet djathtas nga rruga kryesore (aut/h),

3.8. Kriteri i nivelit të shërbimit

Kufijtë e nivelit të shërbimit janë dhënë në Tabelën 3.3, sipas kriterit të humbjeve të përgjithshme kohore. Humbjet e përgjithshme kohore nënkuptojnë kohën nga momenti i qëndrimit të automjetit në fund të vargut deri në momentin kur automjeti lëshon vijën “stop”.

Mesatarja e humbjeve kohore është në funksion të kapacitetet në hyrje të udhëkryqit dhe shkallës së qarkullimit të ngopur. Për rastet kur shkalla e qarkullimit të ngopur është më e madhe se 0.9, madhësia e humbjeve kohore varet edhe nga madhësia e periudhës së analizuar. Për periudhën e analizuar 15- minutash, humbjet kohore llogariten sipas ekuacionit në vijim:

$$D = \frac{3600}{C_{m,x}} + 900 \cdot T \left[\frac{Q_x}{C_{m,x}} - 1 + \sqrt{\left(\frac{Q_x}{C_{m,x}} - 1 \right)^2 + \frac{\left(\frac{3600}{C_{m,x}} \right) \left(\frac{Q_x}{C_{m,x}} \right)}{450 \cdot T}} \right] \quad (3.4)$$

Ku janë:

D – humbjet mesatare kohore,

Q_x – qarkullimi i lëvizjeve “x”,

$C_{m,x}$ – kapaciteti i lëvizjeve “x”,

T – periudha e analizuar (për periudhën kohore 15- minutash, $T = 0,25$).

Humbjet kohore më të vogla se 5 sekonda i përgjigjen nivelit të shërbimit A, ndërsa humbjet kohore prej 45 sekondave janë në kufirin e nivelit të shërbimit E dhe F. Kufiri i nivelit të shërbimit është dhënë në Tabelën 3.4.

Tabela 3.4: Kufiri i nivelit të shërbimit sipas kriterit të kohës së humbur [3]

NSH (Niveli i shërbimit)	Humbjet mesatare kohore [s/aut)
A	≤ 10
B	> 10 dhe ≤ 15
C	> 15 dhe ≤ 25
D	> 25 dhe ≤ 35
E	> 35 dhe ≤ 50
F	> 50

3.9. Njohuri të përgjithshme për rrethrotullimet

Paraqesin numrin e kryqëzimeve me prioritet të thjeshta dhe me shirita qarkullues të ndërlidhur. Rruga kryesore është njëdrejtimëshe dhe i gjithë qarkullimi hyrës apo dalës do të kthehet në të djathtë. Përdorimi i udhëkryqeve me rrethrotullim janë më të sigurta, efektive dhe kanë një kosto mjaftë të ulët ndërtimi dhe mirëmbajtje. Këto rrethrotullime mund të aplikohen si në vendbanim ashtu edhe jashtë vendbanimit dhe mund të projektohen duke u bazuar në filozofi të ndryshme të trafikut.

Qarkullimi hyrës duhet ti jap përparësi kalimi qarkullimit rrotullues dhe këmbësorëve, ndërsa qarkullimi në dalje duhet ti japë përparësi vetëm këmbësorëve mundësisht edhe qarkullimit rrotullues të biçikletave.

Rekomandohet që qarkullimi rrethor të projektohet duke pasur parasysh sigurinë dhe sipas planeve gjeometrike që nuk lejojnë shpejtësi të mëdha.

3.10. Siguria në rrethrotullim, pikat konfliktuoze

Rritja e sigurisë në kryqëzim me rrethrotullim paraqet si rrjedhojë e zvogëlimit të numrit të pikave konfliktuoze në raport me kryqëzimet klasike si dhe zvogëlimi i shpejtësisë si në hyrje po ashtu edhe gjatë lëvizjes në rreth, e cila është e kushtëzuar nga forma gjeometrike e kryqëzimit. Zvogëlimi i numrit të pikave konfliktuoze ndodh si te konfliktet automjet-automjet, po ashtu edhe automjet-këmbësor. Në Figurën 3.2 janë paraqitur pikat konfliktuoze për kryqëzimet klasike dhe atyre me rrethrotullim.




Figura 3.2: Pikat konfliktuoze automjet-automjet dhe automjet-këmbësor [4, 5]

Nga figura shihet se pikat konfliktuoze të udhëkryqet me rrethrotullim janë zvogëluar në krahasim me at klasik. Kështu te kryqëzimet klasike kemi 32 pika konfliktuoze, për derisa te kryqëzimet me rrethrotullim janë 8 pika konfliktuoze [4]. Te kryqëzimet me rrethrotullim me dy shirita të komunikacionit, kujdes të posaqëm duhet kushtuar hyrjes, ashtu që te mos vjen deri te shfrytëzimi i gabuar i shiritit të komunikacionit përkatësisht manovrimit jo të drejtë.

3.11. Elementet gjeometrike të rrethrrrotullimeve

Elementet gjeometrike të rrethrrrotullimeve janë, Figura 3.3:

Ishulli qendror-është pjesa qendrore e rrethrrrotullimit, rrezja e të cilit varet nga madhësia e rrethit.

Ishulli ndarës - janë ndarësit ndërmjet hyrjeve dhe daljeve.

Rruga rrotulluese – është rruga e përdorur nga automjetet që lëvizin në formë rrethore

Aproni – është një formë rrethore rreth rreth ishullit qendrore cila përdoret vetëm për automjete komerciale.

Sinjalizimi horizontal në hyrje – janë vijat horizontale në hyrje të rrethrrrotullimit.




Figura 3.3: Veçoritë e përmasave gjeometrike në rrethrrrotullim [4]

3.12. Kategoritë e qarkullimeve rrethor

Në bazë të madhësisë së rrethrrrotullimit ekzistojnë këto lloje të rrethrrrotullimeve:

- *Miniqarkullimet rrethore,*
- *Qarkullimet rrethore kompakte urbane,*
- *Qarkullimet rrethore me një shirit urban,*
- *Qarkullimet rrethore me dy shirita urban,*
- *Qarkullimet rrethore me një shirit rural dhe*
- *Qarkullimet rrethore me dy shirita rural.*

3.13. Mini-rrethrrrotullimet

Mini-rrethrrrotullimet janë qarkullime të vogla dhe të përdorura në ambiente urbane me shpejtësi të vogla [4].

Veçoritë e mini-rrethrrrotullimeve janë:

- *Kërkojnë shtesa minimale të rrugëve ekzistuese,*
- *Kanë shpejtësi të vogla në hyrje rreth 25 [km/h],*

- Kanë diametra të rrethit të brendshëm (diametri i jashtëm i rrugës rrethore) afërsisht 25 [m],
- Kanë kalime të shkurta këmbësorësh dhe rrugë indirekte,
- Automjetet e pasagjerëve mundë të qëndrojnë në rrugën rrethore,
- Automjetet e mëdha mund të kalojnë mbi ishujt qendror (janë të kalueshëm).

3.14. Rrethrotullimet kompakte urbane

Rrethrotullimet kompakte urbane duhet të projektohen në atë mënyrë që pos automjeteve, tu mundësohet kyçje këmbësorëve dhe çiklistëve [4], Figura 3.4:

Rrethrotullimet kompakte urbane kanë:

- Shpejtësi të vogla në hyrje – afërsisht 25 km/h,
- Diametër të brendshëm afërsisht 30 m,
- Shirita tek në hyrje dhe rrugë rrethore,
- Rrugë mbushëse pingul në rrethin,
- Kalime këmbësorësh dhe rrugë dytësore të shkurtra,
- Ishuj qendror dhe ndarës reliev,
- Sipërfaqe qarkulluese (apron) për akomodimin e automjeteve të rënda,
- Mund të kenë ndarës ndërmjet rrugës dhe kalimeve të këmbësorëve (zona të ngritura).




Figura 3.4: Paraqitja grafike e minirrotullimeve dhe rrethrotullimit kompakt urban [4, 5]

3.15. Elementet themelore të projektimit të rrethrotullimit

Për projektimin e rrethrotullimeve, një numër i madh elementesh themelor duhet pasur kujdes dhe koordinuar për të analizuar rezultatet finale. Tre prej tyre veçanërisht të rëndësishëm janë:

- Shpejtësia,
- Distanca e pamjes dhe
- Madhësia e automjeteve.

3.16. Shpejtësia

Për arsye sigurie, është shumë e rëndësishme që të mos jetë e mundur për automjetet të kalojnë rrethrotullimet me shpejtësi të mëdha.

Natyrisht, nëse hapësira e rrugës është e mjaftueshme për automjetet e mëdha, atëherë krijohen kushtet për automjetet e vogla që të lëvizin me shpejtësi të mëdha.

Kjo gjë duhet të evitohet nga një kombinim masash:

- *Degët të jenë pingul me rrethin,*
- *Rreze hyrëse dhe dalëse sa më të vogla që të jetë e mundur,*
- *Devijime horizontale të mjaftueshme për automjetet në hyrje ,*
- *Aprone të kalueshme për të zgjeruar ishujt qendror për automjetet e mëdha,*
- *Jo më shumë gjerësi të rrugëve rrethore se sa është e nevojshme për të akomoduar automjetet e mëdha,*
- *Zona të tjera të kalueshme në hyrje dhe dalje dhe*
- *Masa shtesë për reduktimin e shpejtësisë.*

3.17. Distanca e pamjes

Automjetet që hynë në rrethrotullim duhet të kenë mundësi të shohin automjetet të cilëve duhet tu japin përparësi. Prandaj është e rëndësishme të mundësohet distanca e mjaftueshme e dukshmërisë:

- *Për automjetet që qarkullojnë në rrethrotullim dhe*
- *Për automjetet që lëvizin nga degët në krah të majtë.*

Distanca e nevojshme (kritike) e dukshmërisë është dhënë në Figurën 3.5.

- d_1 - *distanca e lëvizjes hyrëse*
- d_2 - *distanca e lëvizjeve qarkulluese*

Gjatësia e degëve afruese e pamjes trekëndore duhet të limitohet në 15 m.




Figura 3.5: Distanca e dukshmërisë në hyrje të rrethrotullimit [4, 5]

3.18. Rekomandimet e përmasave të diametrit të brendshëm dhe shpejtësive në hyrje të rrethrotullimit

Në Tabelat 3.5, 3.6 dhe 3.7 janë dhënë përmasat e diametrit të brendshëm dhe shpejtësive përkatëse të rrethrotullimeve [4].

Tabela 3.5: Struktura dhe madhësitë e udhëkryqeve me qarkullim rrethor

Kategoria e qarkullimit rrethor	Llojet e automjeteve që qarkullojnë	Përmasat e diametrit të brendshëm[m]
Mini qarkullim rrethor	Kamionët	13 – 25
Kompakt urban	Kamionët –Autobusët	25 – 30
Qarkullimi rrethor me një shirit urban	Automjete me Rimorkio	30 – 40
Qarkullimi rrethor me dy shirit urban	Automjetet me Rimorkio	45 – 55
Qarkullimi rrethor me një shirit rural	Automjete me Rimorkio	35 – 40
Qarkullimi rrethor me dy shirita rural	Automjete me Rimorkio	55 – 60

Tabela 3.6: Rekomandimet e shpejtësive të lëvizjes së automjeteve në rrethrotullim [4]

Kategoria e qarkullimit rrethor	Rekomandimi i projektimit të shpejtësisë [km/h]
Mini qarkullim rrethor	25 [km/h]
Kompakt urban	25 [km/h]
Qarkullimi rrethor me një shirit urban	35 [km/h]
Qarkullimi rrethor me dy shirita urban	40 [km/h]
Qarkullimi rrethor me një shirit rural	40 [km/h]
Qarkullimi rrethor me dy shirita rural	50 [km/h]

Tabela 3.7: Rekomandimet e minimumit të gjerësisë së rrugës rrethore me dy shirita ku trafiku i gjysmë rimorkiatorëve është relativisht i rallë [4].

Diametri i brendshëm i rrethit	Gjerësia minimale e shiritit rrethor	Diametri i ishullit qendror
45 [m]	9.8 [m]	25.4 [m]
50 [m]	9.3 [m]	31.4 [m]
55 [m]	9.1 [m]	36.8 [m]
60 [m]	9.1 [m]	41.8 [m]
65 [m]	8.7 [m]	47.6 [m]
70 [m]	8.7 [m]	52.6 [m]

3.19. Përparësitë dhe të metat e përdorimit të udhëkryqeve me rrethrotullim

Disa nga përparësit dhe të metat e rrethrotullimev:

Përparësitë:

- Zvogëlimi i konflikteve automjet-automjet
- Zvogëlimi i konflikteve automjet-këmbësorë
- Humbje kohore shumë të vogla
- Numri i automjeteve në pritje(në hyrje të rrethrotullimit) është shumë i vogël

- Nivel të lartë të shërbimit etj.

Mangësitë:

- Ndashjet gjatë kyqjes
- Ndashjet gjatë gërshetimit
- Goditja në rrethin qendror
- Vetërrotullimi
- Ngasja në kahun e gabuar etj.

3.20. Sinjalizimi në rrethrotullim

Në përgjithësi koncepti i sinjalizimit të qarkullimeve rrethore është i njëjtë me udhëkryqet e zakonshme. Sinjalet duhet të vendosen në vendet ku kanë dukshmërinë maksimale nga përdoruesit e rrugës, por nuk duhet që të ndikojnë në zvogëlimin e dukshmërisë momentale të këmbësorëve ose biçiklistëve të cilët janë pjesëmarrësit më të dobët të trafikut [5, 22].

Në Tabelën 3.8 janë paraqitur disa shenja të cilat vendosen në rrethrotullim.

Tabela 3.8: Disa lloje të shenjave sinjalizuese vertikale të qarkullimeve rrethore

 <p>Kryqëzim me rrugën me përparësi kalimi (e cila vendoset në hyrjet e të gjitha qarkullimeve rrethore)</p>	 <p>Afërsia e qarkullimit rrethor (vendoset në afërsi të rrethrotullimit varësisht nga kategoria e tij)</p>	 <p>Kufizimi i shpejtësisë së lejuar</p>
 <p>Qarkullimi rrethor</p>	 <p>Vendkalimi i shënuar për këmbësorë</p>	 <p>Drejtimit i detyruar</p>

Në Figurën 3.6 është paraqitur vendi dhe mënyra e vendosjes e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrethrotullime urbane.




Figura 3.6: Sinjalizimi i qarkullimeve rrethore urbane

3.21. Koncepti i udhëkryqeve me sinjalizim

Udhëkryqet me sinjalizim janë nyje rrugore të krijuara për rregullimin e lëvizjes së automjeteve dhe kalimtarëve në rastet kur numri i tyre është i madh, ka kërkesa për rregullim të lëvizjes dhe kërkesat për shërbim janë të shtuara. Ato janë forma kryesore e udhëkryqeve të kontrolluara me sinjal të trafikut. Këto udhëkryqe ofrojnë shërbimin e të drejtës për lëvizje në formë të kontrolluar në një drejtim. Qëllimi kryesor është reduktimi i konflikteve me anë të kontrollit, duke tentuar të reduktojnë konfliktet në raportin automjet-automjet, automjet-kalimtar, automjet-mjet hekurudhor.

Kapaciteti i një rruge urbane është shumë i ndërlidhur me kohët e sinjaleve dhe karakteristikat gjeometrike të udhëkryqit, si dhe me përbërjen e trafikut. Gjeometria është karakteristikë fikse e udhëkryqit, kapaciteti është veti që zakonisht është vlerë stabile, ndërsa përbërja e trafikut ndryshon me kohë dhe ka vëllim të trafikut.

Qëllimet kryesore të krijimit të udhëkryqit me sinjalizim janë dy kryesore:

- *Ofrim të sigurisë për pjesëmarrësit e trafikut, duke përfshirë shoferët, pasagjerët, kalimtarët, biçiklistët,*
- *Ofrojnë lëvizje më efektive të të gjithë pjesëmarrësve të trafikut në udhëkryq.*

Përparësitë e kontrollit të udhëkryqit me sinjal-semafor, nëse janë dizajnuar mirë, punojnë mirë dhe mirëmbahen mirë janë:

- *Lëvizje të rregullt të trafikut, pa pengesa të mëdha, në situata komplekse të trafikut,*
- *Rrisin kapacitetin e udhëkryqit, e me këtë edhe nivelin e shërbimit, nëse janë realizuar sinjalizimet si duhet dhe plotësojnë kërkesën e trafikut,*

- *Shtimi i sigurisë. Reduktojnë frekuencën dhe ashpërsinë e disa llojeve të aksidenteve, sidomos aksidenteve ballore-anësore të automjeteve dhe me kalimtare,*
- *Janë të koordinuara të ofrojnë lëvizje kontinuale në shpejtësi të definuar përgjatë marshutës së lëvizjes dhe në kushte të favorshme,*
- *Përdoren për ndaluar trafikun me vëllim të madhë për ti lejuar trafikut me vëllim më të vogël, apo kalimtarëve për të kaluar rrugën,*

Mangësitë e kontrollit të udhëkryqit me sinjal-semafor, nëse nuk janë dizajnuar mirë janë:

- *Mundësia e lartë e mos koordinimit në mes të sinjaleve,*
- *Vonesat e shtuara,*
- *Pjesëmarrësit në trafik nuk e respektojnë sinjalizimin, hyjnë në portokalli, hyjnë në të kuqe, kërkojnë rrugë tjera për të evituar udhëkryqin, etj.*
- *Ngritje e frekuencës së aksidenteve.*

3.22. Sinjalizimi në udhëkryq

Operacionet e sinjalizimit në udhëkryq do ti definojmë me këta parametra: *Rregullimi i fazave të lëvizjes dhe Diagramet fazore.*

Procesi i analizës dhe përcaktimit të sinjalizimit realizohet në këto veprime (Fig. 3.7). Për secilin veprim duhet të bëhet planifikimi dhe kalkulimi i proceseve [2].




Figura 3.7: Planifikimi i sinjalizimit të udhëkryqit

3.23. Diagramet fazore

Me krijimin e lëvizjeve në një udhëkryq me sinjalizim duhet ditur se jo gjithmonë lëvizjet mund të sinkronizohen së bashku. Ka disa lëvizje që nuk mund të shkojnë në një fazë në asnjë mënyrë. Me qëllim të identifikimit të lëvizjeve të përbashkëta krijohen diagramet fazore.

Diagrami fazor është diagrami që paraqet grupet e lëvizjeve në faza, dhe secila fazë është e paraqitur në një bllok.

3.24. Llojet e rregullimit të lëvizjes në të majtë dhe në të djathtë të automjeteve

Në terminologjinë e teknikës së trafikut dhe në softuerët e simulimit (*Trafficware*) janë definuar edhe llojet e ndryshme të rregullimit të kthimit në të majtë apo në të djathtë për të rregulluar më mirë fazat e sinjalizimit.

Llojet e kthimit në të majtë:

I lejuar (*ang. Permitted*) – Ka sinjal të gjelbër të plotë të semaforit për lëvizje në të majtë, por sinjali i gjelbër është në fazë të njëjtë me sinjalin e gjelbër nga lëvizja e kundërt drejt, prandaj lëvizja në të majtë bëhet duke konsideruar trafikun nga drejtimi i kundërt dhe nga kalimtarët. Nuk përdoret kurrë sinjalizimi me shigjetë. Ky lloj i lëvizjes mund të reduktojë

vonesat për udhëkryq, por mund të ndikojë negativisht në sigurinë e udhëkryqit, pasi shoferët duhet të presin për zbrazëtirat në udhëkryq për të kaluar [2].




Figura 3.8: Diagram fazor me llojin e kthimit majtas - i lejuar

I mbrojtur (ang. *Protected*) – Ka sinjal të semaforit të gjelbër dedikuar me shigjetë të lëvizjes në të majtë. Lëvizjet në të majtë janë me fazë të dedikuar.



Figura 3.9: Diagram fazor me llojin e kthimit majtas - i mbrojtur

I lejuar + i Mbrojtur (Ang. *Permitted+Protected*) – Ekziston kthimi në të majtë me sinjal të dedikuar (me shigjetë), por lejohet kthimi edhe në të gjelbër të plotë të lëvizjes drejt. Për këtë opsion zakonisht instalohen semaforët me 4 sinjale, i fundit ne shigjetë në të majtë [2].




Figura 3.10: Diagram fazor me llojin e kthimit majtas – i lejuar + i mbrojtur

3.25. Fazat e kalimtarëve

Fazat e kalimtarëve në udhëkryq me sinjalizim janë paraqitur në diagramet fazore më lartë. Këto faza zakonisht rregullohen njëkohësisht me fazat e lëvizjes drejt dhe paralele të automjeteve në udhëkryq. Kjo bëhet për të thjeshtësuar operacionet e udhëkryqit. Por, ky aplikim krijon shumë probleme pasi krijon konflikte të kalimtarëve me lëvizjet e automjeteve djathtas dhe majtas që operojnë në llojin e lejuar të lëvizjes, për shkak se lëvizin në të njëjtën kohë. Për të zgjedhur këtë problematikë, janë aplikuar tri metoda të rregullimit të fazave të kalimtarëve:

Intervali i hershëm i kalimtarëve – Ky interval fillon disa sekonda para se të realizohen fazat e lëvizjes paralele drejt të automjeteve. Kjo i mundëson kalimtarëve të lëvizin në vendkalim të tyre më të hershëm dhe me këtë të reduktojnë konfliktet me automjetet që kthehen majtas apo djathtas. Ky opsion përmirëson sigurinë për kalimtarë duke u mundësuar të shtohet

dukshmëria në udhëkryq dhe aplikohet në udhëkryqe ku ka konflikte të shtuara kalimtarë-automjet.

Intervali i vonshëm i kalimtarëve – Është ngjashëm me intervalin e hershëm, por intervali fillon pak sekonda pas fazës së lëvizjes drejt dhe paralele të automjeteve në udhëkryq. Ky opsion mundëson që kthesat në të majtë apo në të djathtë të lirohen para se të fillojë faza e kalimtarëve, veçanërisht lëvizja në të djathtë. Aplikohet në udhëkryqet ku ka: vëllim të madh të kthimit në të djathtë, ka korsi ekskluzive në të djathtë, ose rrugët të cilat kryqëzohen kanë trafik në një drejtim.

Intervali ekskluziv i kalimtarëve – Paraqet rastin kur ekziston një fazë e tërë e dedikuar për të gjitha kalimtarët. Kjo fazë shtesë është konfiguruar në atë mënyrë që të mos ketë asnjë lëvizje tjetër të automjeteve që bien në konflikt me kalimtarët. Gjatë kësaj faze kalimtarët mund të lëvizin në cilëndo vendkalimit të tyre, por edhe në drejtim diagonal nëse ka nevojë.

Një fazë e tillë ka përparësi sepse redukton konfliktet në mes të automjeteve dhe kalimtarëve, por redukton ndjeshëm kapacitetin e lëvizjes së automjeteve dhe zgjatë gjatësinë e ciklit, e me këtë edhe vonesat për të gjithë përdoruesit [2].




Figura 3.11: Diagram fazor standard i lëvizjes së kalimtarëve

3.26. Niveli i shërbimit për udhëkryq të sinjalizuar

Parametri kryesor i definimit të nivelit të shërbimit (ang. LOS) është vonesa e kontrolluar, që paraqet parametrin e frustrimit dhe komfortit të dobët të shoferit, konsumimit të karburantit, dhe kohës së zgjatur të udhëtimit. Shkalla kritike v/c varet nga shkallët e qarkullimit të korsive kritike dhe fazave të sinjalizimit. Nivelet e shërbimit janë definuar për të paraqitur intervalet e arsyeshme të vonesës së kontrolluar.

Në Tabelën 3.9 janë paraqitur nivelet e shërbimit për vonesat e kontrolluara mesatare për automjet për secilën grup të korsive të marrë për studim, të përmbledhura për secilin afrim në udhëkryq, dhe për tërë udhëkryqin [2].

Tabela 3.9: Përcaktimi i nivelit të shërbimit për udhëkryq të sinjalizuar [2].

NSH (Niveli i shërbimit)	Vonesat e kontrolluara për automjet (s/aut)
A	≤ 10
B	$> 10 - 20$
C	$> 20 - 35$
D	$> 35 - 55$
E	$> 55 - 80$
F	> 80

4. ANALIZA E TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NË RRJETIN RRUGOR TË SHQYRTUAR DHE IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE

Incizimi respektivisht numërimi në trafik është bazë e planifikimit të qarkullimit në komunikacion.

Gjatë matjeve të bëra në teren fitohet një pasqyrë momentale ekzistuese e qarkullimit në trafik, prej nga rezultojnë nevojat aktuale për rikonstruktim, ndërtim të drejtimeve të reja në trafik apo edhe për përmirësimin (ndërrimin e formës së udhëheqjes) e qarkullimit ekzistues.

Numërimi në rastin tonë është bërë në mënyrë manuale ku kemi pasur për detyrë të numërojmë qarkullimin e automjeteve për të dhënat: dita, data, kushtet klimatike, ora e fillimit dhe e mbarimit të numërimit.

Në këtë punim diplome numërimi është bërë me metodën e shënimit në formular. Numërimi është bërë për tri ditët dhe tri herë në ditë në orët kulmore.

Ditët dhe orët e numërimit janë:

- **E hënë, (07:30-08:30, 12:30-13:30, 17:00-18:00),**
- **E premte, (07:30-08:30, 12:30-13:30, 17:00-18:00),**
- **E shtunë, (07:30-08:30, 12:30-13:30, 17:00-18:00).**

Arsyet e zgjidhjes së këtyre ditëve qëndron në faktin se, në bazë të analizave që kemi bërë kemi vërejt se në këto ditë krijohen tollovi më të mëdha. Ditën e shtunë e kemi marr për arsye se është ditë tregu në këtë komunë.

4.1. Të dhënat për qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve për udhëkryqin që lidhë rrugët “Skënderbeu” dhe “Zahir Pajaziti”

Udhëkryqi është i formës “T” dhe lidhë rrugët “Skënderbeu” dhe “Zahir Pajaziti” është i rregulluar me sinjalizim horizontal dhe vertikal. Po ashtu karakterizohet me një numër të madhe të qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve.

Në Figurën 4.1 është paraqitë gjendja ekzistuese e udhëkryqit të rrugëve “Skënderbeu” dhe “Zahir Pajaziti” me hyrjet përkatëse.



Figura 4.1: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit të rrugëve “Skënderbeu” dhe “Zahir Pajaziti”

Në Tabelën 4.1 janë dhënë numri i automjeteve për secilin hyrje për udhëkryqin e parë, për tri ditë e javës si dhe për tri periudha të ndryshme kohore të numërimit.

Sqarim: Automjetet e rënda (Buss-AK) gjatë ekuivalentimit në automjete të udhëtarëve janë shumëzuar me 1.5 kur pjerrtesia e rrugës ka qenë 0%, ndërsa kur pjerrtësia ka qenë 2% janë shumëzuar me 2.

Tabela 4.1: Të dhënat e numërimit për ditën e hënë

Numërimi i automjeteve			
Dita e numërimit	Data	Kushtet klimatike	Sipërfaqja e rrugës
E hënë	14.12.2020	Me diell	E terur

Hyrja: 1						
Ora e numërimit	7:30-8:30		12:30-13:30		17:00-18:00	
Struktura e qarkullimit	Auto	Buss – AK	Auto	Buss – AK	Auto	Buss - AK
Drejtë	76	3	225	15	182	9
Djathtas	0	0	0	0	0	0
Majtas	58	0	95	3	78	0
Gjithësejtë	134	3	320	18	260	9
	139		347		274	

Hyrja: 2						
Ora e numërimit	7:30-8:30		12:30-13:30		17:00-18:00	
Struktura e qarkullimit	Auto	Buss – AK	Auto	Buss – AK	Auto	Buss - AK
Drejtë	70	6	165	21	132	9
Djathtas	156	9	271	6	250	3
Majtas	0	0	0	0	0	0
Gjithësejtë	226	15	436	27	382	12
	249		477		400	

Hyrja: 3						
Ora e numërimit	7:30-8:30		12:30-13:30		17:00-18:00	
Struktura e qarkullimit	Auto	Buss – AK	Auto	Buss – AK	Auto	Buss - AK
Drejtë	0	0	0	0	0	0
Djathtas	55	0	144	0	129	0
Majtas	101	3	341	3	298	0
Gjithësejtë	156	3	485	3	427	0
	161		490		427	

Tabela. 4.2: Të dhënat e numërimit për ditën e premte

Numërimi i automjeteve			
Dita e numërimit	Data	Kushtet klimatike	Sipërfaqja e rrugës
E premte	18.12.2020	Me Diell	E terur

Hyrja: 1						
Ora e numërimit	7:30-8:30		12:30-13:30		17:00-18:00	
Struktura e qarkullimit	Auto	Buss – AK	Auto	Buss – AK	Auto	Buss - AK
Drejtë	88	9	250	18	150	9
Djathtas	0	0	0	0	0	0
Majtas	70	0	125	3	140	0
Gjithësejtë	158	9	375	21	290	9
	172		407		313	

Hyrja: 2						
Ora e numërimit	7:30-8:30		12:30-13:30		17:00-18:00	
Struktura e qarkullimit	Auto	Buss – AK	Auto	Buss – AK	Auto	Buss - AK
Drejtë	59	9	275	13	155	11
Djathtas	138	3	325	8	236	5
Majtas	0	0	0	0	0	0
Gjithësejtë	197	12	600	21	391	16
	215		632		415	

Hyrja: 3						
Ora e numërimit	7:30-8:30		12:30-13:30		17:00-18:00	
Struktura e qarkullimit	Auto	Buss – AK	Auto	Buss – AK	Auto	Buss - AK
Drejtë	0	0	0	0	0	0
Djathtas	61	0	163	0	119	0
Majtas	132	3	330	6	281	0
Gjithësejtë	193	3	493	6	400	0
	198		502		400	

Tabela 4.3: Të dhënat e numërimit për ditën e shtunë

Numërimi i automjeteve			
Dita e numërimit	Data	Kushtet klimatike	Sipërfaqja e rrugës
E shtunë	19.12.2020	Me Diell	E terur

Hyrja: 1						
Ora e numërimit	7:30-8:30		12:30-13:30		17:00-18:00	
Struktura e qarkullimit	Auto	Buss – AK	Auto	Buss – AK	Auto	Buss - AK
Drejtë	122	21	203	19	165	6
Djathtas	0	0	0	0	0	0
Majtas	52	2	87	3	90	0
Gjithësejtë	174	23	290	22	255	6
	209		323		264	

Hyrja: 2						
Ora e numërimit	7:30-8:30		12:30-13:30		17:00-18:00	
Struktura e qarkullimit	Auto	Buss – AK	Auto	Buss – AK	Auto	Buss - AK
Drejtë	201	22	260	21	155	12
Djathtas	116	4	268	6	236	4
Majtas	0	0	0	0	0	0
Gjithësejtë	317	26	528	27	391	16
	356		569		415	

Hyrja: 3						
Ora e numërimit	7:30-8:30		12:30-13:30		17:00-18:00	
Struktura e qarkullimit	Auto	Buss – AK	Auto	Buss – AK	Auto	Buss - AK
Drejtë	0	0	0	0	0	0
Djathtas	80	0	121	5	85	0
Majtas	128	3	224	6	290	5
Gjithësejtë	208	3	345	11	375	5
	213		362		383	

Në Figurën 4.2 është paraqitur mesatarja e qarkullimit të automjeteve për tri ditët e javës. Siç vërehet nga figura 95% janë automjete të udhëtarëve dhe vetëm 5% automjete të rënda (autobus dhe automjete komerciale).




Figura 4.2: Struktura e qarkullimit për ditën e hënë, premte dhe ditën e shtunë

Në Figurën 4.3 është paraqitur jolineariteti i qarkullimit për tri ditët e javës të marra për analizë. Nga figura vërehet se qarkullimin më të madhë për këtë udhëkryq e kemi në ditën e premte në periudhën kohore 12:30-13:30 [h].




Figura 4.3: Jolineariteti i qarkullimit të automjeteve (për ditën e hënë, e premte dhe ditën e shtunë)

4.2. Llogaritja e kapacitetit dhe nivelit të shërbimit për udhëkryqin e rrugëve “Skënderbeu” dhe “Zahir Pajaziti”

Në Figurën 4.4 është prezantuar gjendja ekzistuese e udhëkryqit të rrugëve “Skënderbeu” dhe “Zahir Pajaziti”, me hyrjet përkatëse.




Figura 4.4: Gjendja ekzistuese e udhëkryqit të rrugëve “Skënderbeu” dhe “Zahir Pajaziti”

Në Tabelën 4.4 janë dhënë numri i automjeteve për secilin drejtim. Llogaritja është bërë për ditën e premtë ne periudhën prej orës **12:30 deri 13:30**, pasi që qarkullimi është më i madhë në këtë periudhë.

Tabela 4.4. Ekuivalentimi i automjeteve qarkulluese në automjete të udhëtarëve

Dita /Data		E Premte/18.12.2020				
Koha e matjeve		12:30-13:30				
Shiritat		Kahet e qarkullimit	aut/h	AK/h	PGJ (%)	aut/h
Hyrja I	q ₁	Drejt	249	16	0	273
	q ₂	Majtas	125	3	0	129
Hyrja II	q ₃	Drejt	275	13	0	295
	q ₄	Djathtas	325	8	0	337
Hyrja III	q ₅	Djathtas	163	0	0	163
	q ₆	Majtas	330	6	0	339

Në Tabelën 4.5 janë dhënë të dhënat për numrin e këmbësorëve që frekuentojnë këtë udhëkryq, gjatësia dhe gjerësia e vendkalimit e këmbësorëve.

Tabela 4.5: Të dhënat për vendkalimet e këmbësorëve për udhëkryqin 1

Vendkalimet e këmbësorëve	1K	2K	3K
Flukset e këmbësorëve - Q_K [k/h]	52	69	94
Gjerësia e vendkalimit - G_{SH} [m]	4	4	4
Gjatësia e vendkalimit - L [m]	7	10.5	10.5

RANGU –II :

Llogaritja e kapacitetit potencial dhe nivelit të shërbimit të shiritit për kthim majtas nga rruga kryesore q_2 :

Qarkullimi konfliktuoz q_{c2} :

$$q_{c2} = q_3 + q_4 = 632 \text{ [aut/h]} \quad (4.1)$$

Kapaciteti potencial c_{p2} :

$$c_{p2} = \frac{3600}{t_f} \cdot e^{-\frac{(\sum q_{c2}) \cdot t_0}{3600}} = 857 \text{ [aut/h]} \quad (4.2)$$

Koha e humbur:

$$t_0 = t_g - \frac{t_f}{2} = 3.95 \text{ [s]} \quad (4.3)$$

$t_g = 5.0$ [s] – intervali kritik (intervali kohor minimal i përcjelljes mes automjeteve)

$t_f = 2.1$ [s] – intervali kohorë (vonesa) gjatë nisjes.

Kapaciteti i lëvizjes C_{p2} :

$$C_{p2} = C_{m2} = 857 \text{ [aut/h]} \quad (4.4)$$

Humbjet mesatare kohore:

$$D_2 = \frac{3600}{C_{m2}} + 900 \cdot T \left[\frac{q_2}{C_{m2}} - 1 + \sqrt{\left(\frac{q_2}{C_{m2}} - 1\right)^2 + \frac{\left(\frac{3600}{C_{m2}}\right) \cdot \left(\frac{q_2}{C_{m2}}\right)}{450 \cdot T}} \right] = 6.2 \text{ [s]}$$

$$D_2 = 6.2 \text{ [s]}, \text{ Niveli i Shërbimit "B"} \quad (4.5)$$

Llogaritja e kapacitetit potencial dhe i nivelit të shërbimit të shiritit për kthim djathtas nga rruga dytësore q_5 :

Qarkullimi konfliktuoz q_{c5} :

$$q_{c5} = q_3 + 0.5 \cdot q_4 = 464 \text{ [aut/h]} \quad (4.6)$$

Kapaciteti potencial $c_{p,5}$:

$$c_{p,5} = \frac{3600}{t_f} \cdot e^{-\frac{(\sum q_{c,5}) \cdot t_0}{3600}} = 806 \text{ [aut/h]} \quad (4.7)$$

Koha e humbur:

$$t_0 = t_g - \frac{t_f}{2} = 4.2 \text{ [s]} \quad (4.8)$$

$t_g=5.5$ [s] – intervali kritik (intervali kohor minimal i përcjelljes mes automjeteve)

$t_f=2.6$ [s] – intervali kohorë (vonesa) gjatë nisjes.

Kapaciteti i lëvizjes C_m :

$$C_{m5} = C_{p5} = 806 \text{ [aut/h]} \quad (4.9)$$

Humbjet mesatare kohore:

$$D_5 = \frac{3600}{C_{m5}} + 900 \cdot T \left[\frac{q_5}{C_{m5}} - 1 + \sqrt{\left(\frac{q_5}{C_{m5}} - 1\right)^2 + \frac{\left(\frac{3600}{C_{m5}}\right) \cdot \left(\frac{q_5}{C_{m5}}\right)}{450 \cdot T}} \right] = 5.82 \text{ [s]}$$

$$D_2 = 5.82 \text{ [s]}, \text{ Niveli i Shërbimit "B"} \quad (4.10)$$

RANGU-IV-:

Llogaritja e kapacitetit potencial dhe i nivelit të shërbimit të shiritit për kthim majtas nga rruga dytësore q_6 :

Qarkullimi konfliktuoz q_{c6} :

$$q_{c6} = q_1 + q_2 + q_3 + \frac{1}{2} \cdot q_4 = 866 \text{ [aut/h]} \quad (4.11)$$

$$C_{p6} = \frac{3600}{t_f} \cdot e^{-\frac{q_{c,6} \cdot t_0}{3600}} = 331 \text{ [aut/h]} \quad (4.12)$$

Koha e humbur:

$$t_0 = t_g - \frac{t_f}{2} = 4.8 \text{ [s]}$$

$t_g = 6.5$ [s] – intervali kritik (intervali kohor minimal i përcjelljes mes automjeteve)

$t_f = 3.4$ [s] – intervali kohorë (vonesa) gjatë nisjes.

Kapaciteti i lëvizjes C_m :

$$C_{m6} = C_{p6} = 331 \text{ [aut/h]}$$

Humbjet mesatare kohore:

$$D_6 = \frac{3600}{C_{m6}} + 900 \cdot T \left[\frac{q_6}{C_{m6}} - 1 + \sqrt{\left(\frac{q_6}{C_{m6}} - 1\right)^2 + \frac{\left(\frac{3600}{C_{m6}}\right) \cdot \left(\frac{q_6}{C_{m6}}\right)}{450 \cdot T}} \right] = 175.72 \text{ [s]}$$

$$D_6 = 175.72 \text{ [s]}, \text{ Niveli i Shërbimit "F"} \quad (4.13)$$

Llogaritja e humbjeve të përgjithshme mesatare kohore për tërë udhëkryqin.

$$DU = \frac{D_3 \cdot q_3 + D_5 \cdot q_5 + D_6 \cdot q_6}{q_3 + q_5 + q_6} = 97.17 \left[\frac{s}{aut} \right] \quad (4.14)$$

Në Tabelën 4.6 janë paraqitë humbjet kohore për hyrjet përkatëse për udhëkryqin 1 i cili lidhë rrugët “Skënderbeu” dhe “Zahir Pajaziti”.

Tabela 4.6: Niveli i shërbimit për të gjitha hyrjet për udhëkryqin 1

Qarkullimet në hyrje të udhëkryqit	Humbjet mesatare kohore në rastin e kyqjes në udhëkryq (s/aut)	Humbjet mesatare kohore (s)	Niveli i shërbimit
q_2	$D_2 = 6.2 \text{ [s/aut]}$	$> 5 \text{ dhe } \leq 10$	B
q_5	$D_5 = 5.82 \text{ [s/aut]}$	$> 5 \text{ dhe } \leq 10$	B
q_6	$D_6 = 175.72 \text{ [s/aut]}$	> 45	F
	DU = 97.17 [s/aut]	> 45	F

